

## STATUT

### I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR

#### “BIG LAÇI” SH.P.K

Në datë 05/08/2019 ndërmjet ortakëve;

1. Shoqëria “**BIGALB GROUP**” shpk. Person Juridik shqiptar i regjistruar si i tillë pranë Regjistrimit Tregëtar në QKR, pajisur me Nipt **L11521002M** dhe seli në *Tiranë, Vaqarr, Fshati Gropaj, Godina Tirana Cash & Carry, kati 2*. Me përfaqësuese Ligjore Znj. Elona Koshi, e bija e Tekiut, e dtl. 04.09.1986, e lindur në Gramsh dhe banuese në Tiranë Rruga “3 Dëshmorët”, Yzberisht. Madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi (ID Card) Nr. 033400499 lëshuar më datë 06.06.2017.
2. Fatmir RADA, I biri I Iljaz-it, I datëlindjes 07.09.1969, I lindur në Fushkrujë dhe banues në Fushkrujë, Krujë Rr.Durrësit, Lagjja “Bakushe Visha”, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi (ID Card) Nr. 034168184 lëshuar më datë 24.04.2019.

është themeluar shoqëria tregëtare “**BIG LAÇI**” Sh.p.k. për të zhvilluar aktivitet tregëtar në fusha të ndryshme, si më poshtë:

#### Neni 1

#### EMËRTIMI

Shoqëria është quajtur “Big Laçi” Sh.p.k.

Ajo është një person juridik Shqiptar, e cila do të ushtrojë aktivitet privat në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë pas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Shoqëria “Big Laçi” Sh.p.k zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqipëtar dhe me aktet e themelimit të saj ( Akt-Themelimit dhe Statuti).

Ortakët në këtë sipërmarrje kanë derdhur kapitalin e tyre, me qëllim që të përfitojnë të ardhura, që mund të vijnë nga ushtrimi i veprimtarisë private, si dhe të përfitojnë të ardhura, që mund të vijnë nga ushtrimi i veprimtarisë private, si dhe të përballojnë humbjet në kuotën e pjesëmarrjes së sejcilit ortak.

#### Neni 2

#### OBJEKTI

Objekti i aktivitetit ekonomik të shoqërisë do të jetë:

- Import-eksport, tregëtimin e artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve, me shumicë dhe pakicë si:
- Tregëtim artikuj të ndryshëm industrial;
- Tregëtim artikuj të ndryshëm ushqimore;
- Tregëtim artikuj të ndryshëm bujqësore e blegtorale;
- Tregëtim fruta – perime;
- Tregëtim pije alkolike të ndryshme;

- Tregëtim konfeksione të ndryshme për të rritur dhe fëmijë;
- Tregëtim prodhimesh kozmetike e estetike;
- Tregëtim mallrash të të gjitha llojeve Brenda dhe jashtë vendit;
- Tregëtim automjetesh të cdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjesë këmbimi për to;
- Tregëtim, montim, riparim paisjesh elektro-shtëpiake, elektronike, elektrike, kompjuterike, higjeno-sanitare dhe hidraulike, prodhime qeramike, artizanati, paisje zyrash etj;
- Hapje dhe shfrytëzim hotelesh, motelesh, diskotekash, bar-kafe, lojra argëtuese për fëmijë, qendër sportive, qendra pushimi e kurative;
- Tregëtimin e karburanteve të ndryshëm me pakicë, si dhe vajrave lubrifikante, të gazit të lëngshëm për ngrohje, pajisje ngrohëse gazi si dhe mbushjen e bombolave të gazit dhe tregëtimin e tyre me pakicë.

### Neni 3

Për kryerjen e veprimtarisë së saj Shoqëria do të hapi njësi grumbulluese, përpunuese, shërbimi e tregëtimi, duke bashkëpunuar me persona fizikë ose juridikë, vendase ose të huaj.

### Neni 4

#### SELIA

- Shoqëria “Big Laçi” Sh.p.k. ka selinë e saj në adresën: **Laç, lagjja nr.1, zona kadastrale 2364, nr.pasurie 1/351.**
- Ajo ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, degë, filial, agjensi, si dhe ti suprimojë ato.

### Neni 5

#### KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria Tregtare Private “Big Laçi” Sh.p.k do të ketë një kohëzgjatje të pacaktuar dhe mund të shpërbëhet në cdo kohë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me dispozitat statutore.

### Neni 6

#### KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali fillestar i shoqërisë është **15.000.000 (pesëmbëdhjetë milionë)** lekë, i përberë nga kontributet e ortakëve si më poshtë:

| Emri                        | Kuota    | Përqindja  | Kontributi në lekë |
|-----------------------------|----------|------------|--------------------|
| <b>BIGALB GROUP Sh.p.k.</b> | <b>1</b> | <b>51%</b> | <b>7.650.000</b>   |
| <b>FATMIR RADA</b>          | <b>1</b> | <b>49%</b> | <b>7.350.000</b>   |

Kuotat e kapitalit janë shlyer tërësisht në të holla nga ortakët themelues. Në librat e shoqërisë do të shënohet kapitali i derdhur dhe kuotat e pjesëmarrjes për secilin ortak.

## Neni 7

Pjesët e kapitalit themelor janë plotësisht të transferueshme në rrugë trashëgimnie, në rast ndarje pasurore ndërmjet bashkëshortëve, paraardhësve e pasardhësve.

Të gjitha pjesët e kapitalit të Shoqërisë mund t'u kalojnë, t'u transferohen personave të tretë, që nuk bëjnë pjesë në ortakëri, por gjithmonë me vendim asambleje të ortakëve të shoqërisë dhe me akt noterial.

Trashëgimtari hyn në Shoqëri me të gjitha të drejtat e ortakut dhe me të gjitha efektet.

## Neni 8

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kapitali themelor, dhe të tjera të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë tregtare. Të gjitha pjesët e kapitalit themelor janë tërësisht të shlyeshme dhe të nënshkrueshme nga ortakët e shoqërisë.

## Neni 9

Fitimi i realizuar nga ushtrimi i veprimtarisë ekonomike të Shoqërisë do të administrohet nga ortakët. Një pjesë të këtij fitimi mund të përdoret për zgjerimin e aktivitetit tregëtar. Shoqëria është e detyruar të shlyej të gjitha detyrimet që ka ndaj shtetit dhe të tretëve.

## Neni 10

### ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI NË SHOQËRI

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme thirret për të vendosur, me kërkesën e administratorit ose të cdo ortaku që përfaqëson jo më pak se 10% të kapitalit.

Në cdo rast është në juridiksionin e ortakëve:

- 1) Emërtimi i administratorëve
- 2) Miratimi i llogarive dhe shpërndarja e fitimit
- 3) Emërimi në rastet e parashikuara nga ligji të ekspertëve
- 4) Modifikimi i statusit
- 5) Vendimet lidhur me operacionet që përbëjnë një modifikim thelbësor të objektit të aktivitetit
- 6) Vendime relative:
  - Për realizimin e operacioneve që impenjojnë shoqërinë për një vlerë rast pas rasti më të madhe se 50.000 (pesëdhjetë mijë) Euro
  - Rritje ose zvogëlim të kapitalit
  - Marrjen e kredive
  - Prishjen e shoqërisë
- 7) Cdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendimet e ortakëve dhe vota e tij ka vlerë në proporcion me pjesëmarrjen e tij në kapitalin e shoqërisë.

### Neni 11

Asambleja e Përgjithshme mblidhet cdo vit brenda katër muajve, nga mbyllja e veprimtarisë ekonomike të Shoqërisë.

### Neni 12

#### ADMINISTRATORI

Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. Fatmir Rada**.

Administratori qëndron për një periudhë 5 (pesë) vjecare në detyrë.

Mandati i tij mund të jetë i rinovueshëm. Asambleja e Përgjithshme gëzon të drejtën në cdo kohë të shkarkojë nga detyra administratorin dhe të emërojë një tjetër në vend të tij.

Administratori mundet në cdo moment të emërojë një zëvendës, ta revokojë dhe të emërojë një tjetër në vend të tij.

Administratori ka të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm të shoqërisë për realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, me përjashtim të kompetencave të atribuara vendimarrjes së Asamblesë së Përgjithëshme në kuptim të ligjit dhe të këtij statuti dhe kufizimeve të vendosura në aktin e emërimit të tij.

### Neni 13

#### VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE

#### DHE REZERVA E DOMOSDOSHME

Cdo vit financiar fillon më 1 Janar të cdo viti dhe përfundon më 31 Dhjetor, me përjashtim të vitit të parë, ku si fillim është data e regjistrimit të shoqërisë.

### Neni 14

Llogaritë vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta të hartuara nga administratorët, apo nga ekspertët kontabël miratohen nga Asambleja e Përgjithëshme. Miratimi i dokumentave financiare vjetore bëhet brenda një afati 3-mujor, të mbylljes së vitit financiar.

### Neni 15

Mbas miratimit të llogarive vjetore dhe vërtetimit të ekzistencës së fitimit, mund të krjojë dhe fonde të tjera.

Shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal, afatet e derdhies së sigurimeve shoqërore etj.

Ajo ka të drejtë të celi llogari likujduese pranë bankave të vendit dhe të kryejë veprime likujdimi me to.

### Neni 16

Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi emërohen një nga disa likujdatorë të cilët ndjekin operacionet e likujdimit deri në

fund dhe i paraqesin Asamblesë së Përgjithshme dhe administratorit rezultatet përfundimtare të likujdimi. Në përfundim Asambleja e përgjithshme vendos për heqjen e mandatit të tyre. Të gjitha detyrimet që dalin nga likujdimi, Asambleja e Përgjithshme do të vendosë për mënyrën dhe modalitetet e shlyerjes së tyre.

#### **Neni 17**

Ortakët e Shoqërisë mund të bëjnë ndryshime e plotësime në Statut dhe në aktin e themelimit pa rënë ndesh në mënyrë thelbësore në cdo kohë, me nenet e përshkruara në këtë Statut. Ndryshimet e plotësimet bëhen në të njëjtën mënyrë e procedurë me të cilën nxirret vetë statuti.

#### **Neni 18**

Cështjet e tjera që nuk janë trajtuar në këtë statut, gjithshka i referohet ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” si dhe ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, legjislacionit shqipëtar në fuqi, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tyre.

#### **Neni 19**

Ky statut është përpiluar dhe firmosur në tre kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin.


*Datë 05, 08, 2019*

### **ORTAKËT THEMELUES**

**Shoq. “BIGALB GROUP” Sh.p.k.**

**Përfaqësuese Ligjore**

**ELONA KOSHI**



---

**FATMIR RADA**



---